**R E F E R A T**  
**PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN SHKENCORE KËSHILLTAR SHKENCOR**  
**NË INSH INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE I**  
**SHQIPTARËVE - SHKUP**

Në bazë të konkursit publik të shpallur më 18.04.2018, në gazetën ditore “Lajm” dhe “Nova Makedonija” për zgjedhjen e një Këshilltari shkencor në sektorin Historia e shqiptarëve të Maqedonisë dhe lëvizjeve demografike, Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 26.04.2018, me vendimin nr.0201-151/2, na ka zgjedhur për anëtarë të Komisionit recensues, në përbërje: prof. dr. Ahmet Sherif, (Institut i Historisë Nacionale-Shkup), prof. dr. Nebi Dervishi (Universiteti Shtetëror i Tetovës-Tetovë), prof. dr. Qemal Murati, (Institut i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore -Shkup).

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prashtruar, i dorëzojmë Këshillit të Institutit këtë:

**RAPORT**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues konstaton se për një zgjedhje për titullin Këshilltar shkencor në Departamentin e Historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjet demografike, është paraqitur një kandidat: dr. Naim Alimi - bashkëpunëtor i lartë shkencor. Ky raport i referohet:

**Dr. Naim Alimit** – Bashkëpunëtor i lartë shkencor, i cili paraqitet për zgjedhje në thirrjen Këshilltar shkencor.

**I. Të dhëna biografike dhe arsimimi**

Kandidati dr. Naim (Banush) Alimi u lind më 22. 3. 1955 në f. Shtrazë, Kumanovë, Republika e Maqedonisë. Shkollën fillore e kreu në f. Llojan, të mesmen (gjimnazin) në Kumanovë, kurse studimet për Histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë (1982).

Në vitin 1992 regjistroi studimet posdiplomike në Institutin e Historisë në Tiranë, ku doktoroi në vitin 1997 dhe mori titullin: Doktor i shkencave historike.

Nga viti 1982 ka punuar si profesor në Gjimnazin „Goce Dellçev”, (1982-1983), sh. f. „Vëllazërimi” (1984-1989)”, Naim Frashëri” (1990-1997) dhe në Universitetin e Tetovës (1997-2008), ndërkaq nga viti 2009 në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, ku punon edhe tani si Bashkëpunëtor i lartë shkencor në departamentin Historia e shqiptarëve të Maqedonisë dhe lëvizjet demografike.

Jeton në Kumanovë me familje.

## **II. Vlerësim i veprimtarisë hulumtuese-shkencore të kandidatit, me rëndësi për zgjedhjen në titullin shkencor**

Sipas materialeve të paraqitura, kandidati dr. Naim Alimi, që nga zgjedhja në titullin Bashkëpunëtor i lart shkencor, me vendim të Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, me numër 0201-126/6 të datës 30.6.2014, ka treguar interes të përhershëm në veprimtarinë hulumtuese-shkencore, dhe ka arritur rezultate solide në fushën e shkencave historike dhe më gjerë.

Kandidati dr. Naim Alimi, ka marrë pjesë thuajse në të gjitha projektet dhe konferencat shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, dhe institucionet tjera shkencore dhe të ngjajëshme, shoqata dhe organizata tjera që kanë organizuar sesione, konferenca e seminare në vend dhe jashtë. Publikoi edhe një numër të madh të punimeve shkencore në revista shkencore në vend dhe jashtë (si dhe ka në shtyp katër libra shkencore), të cilat kanë rëndësi të veçantë në fushën e historisë dhe etnologjisë bashkëkohore të shqiptarëve të Maqedonisë. Veçanërisht janë të rëndësishme punimet e tij shkencore që kanë të bëjnë me historinë politike dhe kulturore të shqiptarëve në Maqedoni, disa prej të cilave thuajse janë të vetme në shkencën e këtushme historike.

Dr. Naim Alimi për nevojat e punës së tij, ka bërë hulumtime të rëndësishme, sidomos në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë në Shkup, në Arkivin e Qytetit të Shkupit, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare, „Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup, në Arkivin Shtetëror të Shqipërisë, në Tiranë, si dhe në Arkivin e Kosovës në Prishtinë.

Nga ajo që është publikuar midis dy zgjedhjeve, mund të konstatohet se në preokupimet e tij shkencore është i pranishëm edhe studimi dhe ndriçimi i çështjeve dhe problemeve, para se gjithash nga historia e popullit shqiptar në periudhën para dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

### **- Veprimtaria hulumtuese-shkencore**

Kandidati dr. Naim Alimi, në pikëpamje të veprimtarisë hulumtuese-shkencore, njihet me punimet shkencore në fushën e historisë së shqiptarëve në Maqedoni. Ka botuar veprën „Studime historike dhe etnologjike nga trojet tona etnike”(2017), ndërsa i ka para publikimit katër vepra: 1. Disa personalitete të shquar shqiptar të Karadakut; 2. Etnokultura në trevën shqiptare të Kumanovës; 3. Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia para dhe pas Luftës së Dytë Botërore; 4. Shqiptarët e Maqedonisë në vitet e demokracisë (1990-2000).

Dr. Naim Alimi në këtë periudhë kohore, ka publikuar rreth 15 punime shkencore-profesionale nga sfera e historisë dhe etnologjisë, nga të cilat 2 llogariten në mesin e publikimeve ndërkombëtare.

Si punime me rezultate origjinale shkencore, kemi ndarë punimet e publikuara në revistat shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, ” Studime Albanologjike”, “Scupi”, dhe „Kërkime historike” të SHSHM-së. Në revistën “Studime Albanologjike“ nr. 9, 2014, ka publikuar punimin ”Ushqimi, veshmbathja dhe lojërat popullore te shqiptarët e trevës së Kumanovës”, pastaj ”Masakrat partizane-çetnike në Karadak në mbarim të Luftës së dytë Botërore”(nr. 10.2014), ”Sylë Hotla në historiografinë shqiptare”, (nr. 11,2015), ”Kolonizimi i viseve shqiptare në

Maqedoni ndërmjet dy luftërave botërore”, (nr. 12, 2015), ”Ismet Jashari”, (nr. 13, 2016), ”Disa doke të lindjes e rrite të vdekjes në anën e Kumanovës”, (nr.14.2016), ”Dasma në malësinë e Kumanovës”, (nr.15,2017). Në revistën ”Scupi”, (nr.V.2014), ka publikuar ”Toponimet në rajonin e Kumanovës-dëshmi për autoktoninë e shqiptarëve”, ”Shqiptarët dhe trojet e tyre në propagandën serbe gjatë luftës së parë botërore”, (nr.6,2014), ”Trashëgimia kulturore e shqiptarëve në Maqedoni pasuri e rajonit dhe Evropës”, (nr.9.2015), ”Reforma agrare-kolonizuese në qarkun e Shkupit, ndërmjet dy luftërave botërore”, (nr.12.2015), ”Historiografia shqiptare dhe ajo e huaj për dhe rreth veprimtarisë atdhetare të NDSH-së, (nr. 16,2017), ”Shën Gjergji - festë motmoti në malësinë ( Karadak) të Kumanovës”, (nr. 18, 2017); „Shpërngulja e shqiptarëve nga viset që sot përfshihen në Maqedoni nga luftërat ballkanike deri në Luftën e Dytë Botërore”, ”Kërkime historike”, (nr. 9-10), SHHSHM, Shkup 2017.

Në këtë periudhë kohore prej katër vjet, kandidati dr. Naim Alimi, ka qenë mjaft aktiv nëpër konferenca shkencore dhe takime të ngjashme. Përveç se në Shkup dhe Kumanovë, mori pjesë edhe në konferenca shkencore në Tetovë, Preshevë dhe Prishtinë, ku dha kontribut në paraqitjen shkencore të çështjeve të caktuara të shqiptarëve të këtyre trevave. Këtu, me referate mori pjesë nëpër këto aktivitete shkencore si Konferenca shkencore ”Lufta e Parë Botërore 1914-1918”, ITSHKSH, Shkup, 11. 9. 2014; Konferenca shkencore ”Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni, ITSHKSH, Shkup, 30.09.2014; Konferenca shkencore ”Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore”, ITSHKSH, Shkup, 14-15. 10. 2015; Konferenca shkencore ”70-vjetori i Kongresit II (IV) të NDSH-së në Shkup”, ITSHKSH-Shkup, Shkup, 1. 6. 2016; Konferenca shkencore, ”Prof. Dr. Masar Kodra –Figurë e shquar e historiografisë shqiptare (1932-2003) ”(Me rastin e 85 vjetorit të lindjes), ITSHKSH-Shkup, Shkup, 15.9.2017. Konferenca shkencore,, Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit, ITSHKSH, Shkup dhe Shtëpia Botuese Llogos-A, Shkup, 17.12.2017.

### **III. Veprimtaria mësimore-arsimore**

Dr. Naim Alimi është i kyçur në veprimtarinë mësimore-arsimore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, përkatësisht në studimet pasdiplomike – të magjistraturës, në programin studimor ”Histori me mardhënie ndërkombëtare” të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë në vitin 2014, ku ka ligjëruar tre lëndë mësimore: ”Metodologjia e kërkimit shkencor” (sem.I), ”Unioni evropian-historia, politika, relacionet” (sem.II) dhe ”Diplomacia evropiane dhe Maqedonia” (sem.III). Ka qenë i inkuadruar edhe në Institutin „Pjetër Budi” në Prishtinë 2014/2015, 2015-2016, ku ka ligjëruar nga dy lëndë: „Trashëgimia Kulturore (sem.I) dhe „Ruajtja e trashëgimisë kulturore (sem.II) dhe në UNT në Shkup 2017/2018, „Historia e sportit”(sem. I ).

Gjithashtu, ç’do vit ka qenë i angazhuar në projektin e Institutit,, Java e trashëgimisë kulturore” ndërsa këtë vitë udhëheqë me proektin „Trashëgimia jonë kulturore e natyrore e rajonit të Kumanovës” etj.



#### **IV. Aktiviteti profesional-aplikativ dhe aktiviteti me interes më të gjerë**

Kandidati dr. Naim Alimi ka një spektër të gjerë të veprimtarive në planin profesional-aplikativ dhe aktivitete me interes më të gjerë, edhe atë: Antar i Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (2014-2015) dhe nënkryetar (2016-2018), ku ka treguar interes të madh për zhvillimin e institutit. Është anëtar i kryesisë së Shoqatës së Historianëve Shqiptar të Maqedonisë. Anëtar i komisionit, koorganizator i konferencës shkencore “Lufta e Parë Botërore 1914-1918”, 11 shtator 2014, ITSHKSH, Shkup; antar, koorganizator i tryezës shkencore “Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore”, ITSHKSH, 14-15 tetor 2015, Shkup; Anëtar i Komisionit recensues të ITSHKSH-së, për zgjedhje në thirrje shkencore të një bashkëpunëtori shkencor, 2015; Anëtar i Komisionit recensues të ITSHKSH-së, për zgjedhje në thirrje shkencore të një asistenti hulumtues, 2016; Kryetar i Komisionit recensues të ITSHKSH-së, për zgjedhjen në thirrjen shkencore të dy bashkëpunëtorëve të lartë shkencor, 2016. Anëtar i këshillit redaktues të revistës profesionale-shkencore “Studime Albanologjike”, “Scupi” dhe „Kërkime historike”.

Alimi është bartës i projekti të ITSHKSH-së „Trashëgimia jonë kulturore dhe natyrore në rajonin e Kumanovës” të mbështetur nga Ministria e Arsimit e Republikës së Maqedonisë, 2018.

Në periudhën 2014-2016, dr. Naim Alimi është anëtar i Këshillit nacional për trashëgimi kulturore në ministrinë e Kulturës në Republikën e Maqedonisë, pastaj në dy komisione të trashëgimisë kulturore, si dhe në Komisionin për ndarjen e shpërblimit shtetëror „Shën Klimenti i Ohrit”, etj.

Në vitin 2017, ishte fitues i shpërblimit të madh shtetëror në sferën e arsimit dhe kulturës „Shën Klimenti i Ohrit”, që ndahet nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë.

#### **V. Përfundim dhe propozim**

Duke u bazuar në tërë atë që u tha më lartë, në dokumentacionin e dorëzuar dhe njohjen personale me kandidatin, në kualitetet e fituara shkencore, botimet dhe punimet shkencore në fushën e historisë dhe më të gjerë, pjesëmarrja në tubime shkencore dhe aktivitete të veprimtarive tjera profesionale-aplikative, Komisioni recensues e vlerëson lartë veprimtarinë mësimore-arsimore, hulumtuese-shkencore, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë të kandidatit dr. Naim Alimi.

Në bazë të dhënave të paraqitura mbi aktivitetin e plotë të kandidatit që nga zgjedhja e tij e fundit e deri më sot, Komisioni ka konstatuar se dr. Naim Alimi, posedon kualitete shkencore e profesionale, dhe në tërësi i plotëson kushtet për zgjedhje në titullin *Këshilltar shkencor/Profesor ordinar*, të parapara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes me titull më të lartë shkencor, Rregulloren për procedurën dhe kriteret më të përafërta për zgjedhje në titullin shkencor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/09). Nëpërmjet krahasimit të dokumentacionit të dorëzuar midis dy zgjedhjeve, si komision konstatuam se nuk ekziston përputhshmëri e referencave të parashtruara.

Sipas asaj që u tha më lartë, Komisioni ka nderin dhe kënaqësinë që Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve

në Shkup, t'i propozojë që dr. Naim Alimi, të zgjidhet në thirrjen shkencore  
KËSHILLTAR SHKENCOR/PROFESOR ORDINAR në Departamentin e  
Historisë së shqiptarëve të Maqedonisë dhe lëvizjeve demografike.

Shkup, 30.4.2018

**Komisioni recencues:**

Prof. dr. Ahmet Sherif, kryetar, d.v

Prof. dr. Nebi Dervishi, anëtar, d.v

Prof. dr. Qemal Murati, anëtar, d.v

FORMULAR  
NDAJ RAPORTIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE

**Kandidati: Dr. Naim Alimi**  
**Institucioni: Instituti i trashëgimisë kulturore e shpirtërore të shqiptarëve, Shkup**  
**Fusha shkencore: Shkencat humane, Histori**

VEPRIMTARIA SHKENCORE - PROFESIONALE

	Pikët
Libra nga fusha profesionale	
- autor 1. <i>Studime historike dhe etnologjike nga trojet tona etnike, ITSHKSH, Shkup, 2017</i>	1x 8=8
Punim me rezultate origjinale shkencore, të publikuar në revista profesionale/shkencore: 1. Ushqimi, veshmbathja dhe lojërat popullore të shqiptarët e trevës së Kumanovës „Studime Albanologjike”, nr. 9, ITSHKSH, Shkup, 2014, f. 125-134. 2. Masakrat partizane-çetnike në Karadak në mbarim të Luftës së Dytë Botërore „Studime Albanologjike”, nr. 10, ITSHKSH, Shkup, 2014, f. 143-150. 3. Sylë Hotla në historiografinë shqiptare „Studime Albanologjike”, nr. 11, ITSHKSH, Shkup, 2015, f. 61-64. 4. Kolonizimi i viseve shqiptare në Maqedoni ndërmjet dy Luftërave Botërore „Studime Albanologjike”, nr. 12, ITSHKSH, Shkup, 2015, f. 29-36. 5. Ismet Jashari „Studime Albanologjike”, nr. 13. ITSHKSH, Shkup, 2016, f. 183-186. 6. Disa doke të lindjes e rite të vdekjes në anën e Kumanovës „Studime Albanologjike”, nr. 14, ITSHKSH, Shkup, 2016, f. 171-176. 7. Dasma në malësinë e Kumanovës „Studime Albanologjike”, nr. 15, ITSHKSH, Shkup, 2017, f. 237-243. 8. Shpërngulja e shqiptarëve nga viset e tyre që sot përfshihen në Maqedoni nga Luftërat Ballkanike deri në Luftën e Dytë Botërore, “ Studime historike”, nr. 9-10, SHHSHM, Shkup, 2017, f. 41-51. 9. Shpërngulja e shqiptarëve nga rajoni i Kumanovës (1946-1966) „Studime Albanologjike”, nr. 16, ITSHKSH, Shkup, 2018, f.107-12.	9 x 4 = 36
Punime me rezultate origjinale-shkencore, të publikuara nëpër përmbledhje të punimeve nga tubime profesionale/shkencore:	8x2=16

<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Toponimet në rajonin e Kumanovës, „Scupi”, nr. V, ITSHKSH, Shkup, 2014, f. 157-161.</li> <li>2. Shqiptarët dhe trojet e tyre në propagandën serbe gjatë Luftës së Parë Botërore „Scupi”, nr. 7, ITSHKSH, Shkup, 2014, f. 114-127.</li> <li>3. Trashëgimia kulturore e shqiptarëve në Maqedoni pasuri e rajonit dhe Evropës, „Scupi”, nr. 9, ITSHKSH, Shkup, 2015, f. 15-22.</li> <li>4. Reformat agrare- kolonizuese në qarkun e Shkupit ndërmjet dy Luftërave Botërore „Scupi”, nr. 12, ITSHKSH, Shkup, 2015, f. 101-108.</li> <li>5. Historiografia shqiptare dhe ajo e huaj për dhe rreth veprimtarisë atdhetare të NDSH-së, „Scupi”, nr.16, Shkup, 2017, f.84-89.</li> <li>6. Shën Gjergji- festë motmoti në malësi(Karadak) të Kumanovës, „Skupi”, nr.18, ITSHKSH, Shkup, 2017, f. 110-114.</li> <li>7. Prof.Dr. Masar Kodra-figurë e shquar e historiografisë shqiptare (1932-2003),“ Scupi”, nr.19, ITSHKSH, Shkup, 2018, f. 86-89.</li> <li>8. Xhemijeti në ditarin e Azem Hoxhës, ” Scupi”, nr.20, ITSHKSH, 2018, f.159-161.</li> </ol>	
<p>Pjesëmarrja në tubime profesionale/shkencore me referat:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Konferenca shkencore “Lufta e Parë Botërore 1914-1918”, ITSHKSH, Shkup, 11. 9. 2014;</li> <li>2. Konferenca shkencore “Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni, ITSHKSH, Shkup, 30. 09. 2014;</li> <li>3. Konferenca shkencore “Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore”, ITSHKSH, Shkup, 14–15. 10. 2015;</li> <li>4. Konferenca shkencore “70-vjetori i Kongresit II (IV) të NDSH-së në Shkup”, ITSHKSH–Shkup, Shkup, 1. 6. 2016;</li> <li>5. Konferenca shkencore „ Prof.Dr. Masar Kodra-figurë e shquar e historiografisë shqiptare (1932-2003),”ITSHKSH-Shkup, Shkup, 15. 9. 2017.</li> <li>6. Konferenca shkencore,„Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit, ITSHKSH, Shkup dhe Shtëpia Botuese Logos-A, Shkup, 17.12.2017.</li> </ol>	<p>6x2=12</p>
<p>Udhëheqës i proektit shkencorë nacional: -Trashëgimia kulturore dhe natyrore në rajonin e Kumanovës, 2018</p>	<p>5</p>
<p>Mentor i temave të magjistraturës:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. ”Migracioni-dikur dhe sot, në fokus Maqedonia dhe Shqipëria” e kandidatit Benjad Emini, 2018</li> <li>2. ”Historia e Kombeve të bashkuara dhe sfidat sot”, e kandidatit Misim Dardhishta, 2018.</li> </ol>	<p>2x1,5=3</p>
<p><i>Gjithsejt</i></p>	<p><b>80</b></p>

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Pikët

Mbajtja e mësimit- studimet e ciklit të dytë:	
Studimet e magjistraturës – lënda mësimore: “Metodologjia e kërkimit shkencor” (45 orë) , viti i parë, sem. i parë, 2014;	45x0,04=1,8
„Unioni evropian” (20 orë) , viti i parë, sem. i dytë, 2015;	20x0,05=1
„Diplomacia evropiane dhe Maqedonia” (20 orë), viti dytë, sem. III, 2016.	20x0,05=1
“Metodologjia e kërkimit shkencor”, (45 orë), sem i parë, viti parë, 2015.	45x0,04=1,8
”Unioni evropian”, (20 orë), viti i parë, sem. dytë, 2016);	20x0,05=1
”Diplomacia evropiane dhe Maqedonia (20 orë) viti dytë, 2017.	20x0,05=1
Në Institutin „ Petër Budi” – Prishtinë: Trashëgimia Kulturore (45 orë), viti parë, sem. parë, 2014;	45x0,04=1,8
“Ruajtja e trashëgimisë kulturore” (45 orë), viti parë, sem dytë 2015.	45x0,04=1,8
“Trashëgimia kulturore” (45 orë), viti parë, sem.parë 2015 dhe “Ruajtja e trashëgimisë kulturore (45 orë), viti parë, sem.dytë, 2016.	45x0,04=1,8
Në UNT,Shkup: “Historia e sportit” (60 orë), sem. parë, 2017.	45x0,04=1,8
<b>Gjithsejt</b>	<b>14,8</b>

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Pikët

Anëtar i bordit drejtues të revistës profesionale/shkencore: 1. “Scupi”, nr.11, Shkup, 2014; 2. “Studime Albanologjike”, nr, 9, Skup, 2014; 3. “Studime Albanologjike”, nr, 10, Shkup, 2014; 4. “Studime Albanologjike” , nr. 11, Shkup, 2015; 5. “Studime Albanologjike” , nr, 12, Shkup, 2015; 6. ”Studime Albanologjike” , nr. 13, Shkup, 2016; 7. “Studime Albanologjike”, nr. 14, Skup, 2016; 8. “Studime albanologjike”,nr. 15, Shkup, 2017; 9. “Studime Albanologjike”,nr. 16, Shkup, 2017; 10. “Scupi”, nr.19, Shkup, 2017; 11. “Scupi”, nr.20, Shkup, 2018;	11 x 0,5=5,5
Recensent në libra shkencor/profesional 1. Qerim Lita,, Mardhënjet shqiptare-jugosllave 1968-1981” (dokumente), Shkup, 2014.	7 x0,5 =3,5

<p>2. Skender Asani &amp; Sevdail Demiri, “Vilajeti i Manastirit dhe LKSH në vitet 1911-10129 (Dokumente bullgare)”, Shkup, 2015.</p> <p>3. Etem Xheladini „, Lufta jonë për arsimin shqip’, Kumanovë, 2016.</p> <p>4. Minir Ademi „Hotla nëpër kohë”, Kumanovë, 2017.</p> <p>5. Sevdail Demiri „Variacione historike”, SHHSHM, Shkup, 2017.</p> <p>6. “Shkupi për vitin e Skëndërbeut (1468-2018)”, ITSHKSH, Shkup, 2018</p> <p>7. Q.Lita dhe S.Asani „Kont Bertoldi dhe çështja shqiptqre”; ITSHKSH, Shkup, 2018.</p>	
<p>Anëtar i këshillit organizativ apo programues i tubimit profesional/shkencor:</p> <p>1. Konferencës shkencore “Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore”, ITSHKSH, 14–15 tetor 2015, Shkup;</p> <p>2. Konferenca shkencore, „Nëna Terezë-shqiptarja nga Shkupi, ITSHKSH, Shkup, 2015,</p> <p>3. Konferenc shkencore „Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni, ITSHKSH, Shkup, 2016,</p> <p>4. Konferenca shkencore, „70-vjetori i Kongresit II(IV) të NDSH-së në Shkup”, ITSHKSH, Shkup, 2016,</p> <p>5. Konferenca shkencore „Prof. Masar Kodra-personalitet i shquar i historiografisë shqiptare (1932-2003), ITSHKSH, Shkup, 2017,</p> <p>6. Konferenca shkencore „Organizata Xhemijet dhe qëndresa e saj ndaj kolonizimit”, ITSHKSH, Shkup, 2017,</p> <p>7. Konferenca shkencore, „Shkupi për vitin e Skëndërbeut”, ITSHKSH, Shkup, 2018.</p>	<p>7x0.5 =3,5</p>
<p>1. Anëtar i këshillit të ITSHKSH, Shkup, 2014-2015</p> <p>2. Nënkyetar i Këshillit të ITSHKSH, Shkup, 2016-2018</p> <p>3. Anëtar i Këshillit shkencor në studimet posdiplomike „Histori me mardhënje ndërkombëtare”; ITSHKSH, 2015-2016.</p>	<p>3x2=6</p>
<p>Anëtar i komisioneve shkencore në Institut:</p> <p>1. Anëtar i komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve për studentë në studimet e magjistraturës në ITSHKSH-Shkup, 2014;</p> <p>2. Anëtar i komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve për studimet e magjistraturës në ITSHKSH-Shkup, 20015;</p> <p>3. Anëtar i komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve për studimet e magjistraturës në ITSHKSH-Shkup, 2016;</p>	<p>3 x 0,5 = 1,5</p>

Anëtar i komisioneve për zgjedhje në thirrje shkencore: 1. Anëtar i Komisionit recensues të ITSHKSH-së, për zgjedhje në thirrje shkencore të një bashkëpunëtori shkencor, 2015; 2. Anëtar i Komisionit recensues të ITSHKSH-së, për zgjedhje në thirrje shkencore të një asistenti hulumtues, 2016. 3. Kryetar i komisionit recensues të ITSHKSH-së, për zgjedhje në thirrje shkencore të një bashkëpunëtori të lartë shkencor, 2016, 4. Kryetar i komisionit recensues të ITSHKSH-së, për zgjedhje në thirrje të një bashkëpunëtori të lartë shkencor, 2016.	4 x 0,2 = 0,8
Pjesëmarrje nëpër komisione dhe trupa pune të organeve shtetërore dhe institucioneve tjera: 1. Anëtar i Komisionit profesional të Ministrisë së Kulturës së RM-së, në sektorin e veprimtarisë së muzeve dhe të mirave materiale shkencore për vitin 2014; 2. Anëtar i Komisionit profesional të Ministrisë së Kulturës së RM-së, në sektorin e trashëgimisë së pa tundshme, për vitin 2015; 3. Anëtar i Komisionit për ndarjen e shpërblimit shtetëror "Shën Klimenti i Ohrit", në kuadër të Ministrisë së Kulturës së RM-së, për vitin 2014; 4. Anëtar i komisionit për ndarjen e shpërblimit shtetëror "Shën Klimenti i Ohrit" në kuadër të Ministrisë së Kulturës së RM-së, për vitin 2015; 5. Anëtar i këshillit nacional për trashëgimi kulturore në Ministrinë e Kulturës të RM-së, 2014; 6. Anëtar i këshillit nacional për trashëgimi kulturore në Ministrinë e Kulturës të RM-së, 2015; 7. Anëtar i këshillit nacional për trashëgimi kulturore në ministrinë e Kulturës të RM-së, 2016. 8. Anëtar i komisionit për veprimtari botuese, në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017-2018	8 x 1 = 8
1. Fitues i shpërblimit shtetëror në sferën e arsimit dhe kulturës „Shën Klimenti i Ohrit” , për vitin 2017	5
Gjithsejt	<b>33,8</b>

REFERENCA PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE	Pikët
<b>VEPRIMTARIA HULUMTUESE-SHKENCORE</b>	<b>80</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>14,8</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALO-APLIKATIVE</b>	<b>33,8</b>
<b>Gjithsejt</b>	<b>128,6</b>

Shkup, 30.4.2018

**Komisioni recensues:**

Prof. dr. Ahmet Sherif, kryetar, d.v  
Prof. dr. Nebi Dervishi, anëtar, d.v  
Prof. dr. Qemal Murati, anëtar, d.v

**PASQYRË E TEMAVE TË PRANUARA PËR PUNIMIN E  
MAGJISTRATURËS NË INSTITUTIN E TRASHËGIMISË  
SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE- SHKUP,  
GRUPI HISTORI DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE**

nr	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Titulli i temës	Emri dhe mbiemri i mentorit	Data dhe nr. i vendimit të KMSH për pranimin e temës
01	Driton Osmani	-“Tetova me rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)” -“Тетово и околијата помеѓу двете светски војни (1918-1941)” -"Tetovo with the surroundings between the two world wars (1918-1941)".	Prof.dr. Nebi Dervishi	Datë 10.5.2018 Vendimi nr. 1001-28/2
02	Misim Dardhishta	-“Historia e Kombeve të Bashkuara dhe sfidat e saj sot” -“Историјата на Обединетите нации и нејзините предизвици денес” -"The history of the United Nations and its challenges today"	Prof.dr. Naim Alimi	Datë 10.5.2018 Vendimi nr. 1001-28/3
03	Lulzim Kashtanjeva	-“Mbrojtja e të drejtave të njeriut sipas konventave ndërkombëtare” -“Заштита на човековите	Prof.dr. Ylber Sela	Datë 10.5.2018 Vendimi nr. 1001-28/4



		права според меѓународните конвенции” -“Protection of human rights under international conventions“		
--	--	---	--	--

Drejtor - dekan  
Prof. dr. Skender Asani